

**STATUTI  
I SHOQËRISË TREGTARE**

**“ANIMA 08” SH.P.K**

**ME SELI NË : “Sheshi Italia 1, Arena Center”**

Sot, më datë 10/05/2022 (dymijë e nentembedhjetë), ortaku themelues:

Ka vendosur themelimin e shoqërisë “**ANIMA 08**” SH.P.K me terma si më poshtë:

- **Znj. Vjollca Hoxha**, qytetare Shqiptare, lindur ne Tirane, me **23/03/1969**, rezident ne **Rruga Fatmir Haxhiu, Tirane**, me nr karte identiteti **G95323231L**

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Shoqëria Tregtare “**ANIMA 08**” SH.P.K rregullon pozitën e saj juridike, marrdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrdhëniet e Shoqërive Tregtare

**NENI 1**  
**Emri dhe selia e Shoqërisë**

Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria do te paraqitet në qarkullimin juridik-civil me emërtimin e saj “**ANIMA 08**” sh.p. k dhe emrin tregtar: “**ANIMA 08**” sh.p.k.

**NENI 2**  
**Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresën “Sheshi Italia 1, Arena Center”.

**NENI 3**  
**Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është pa afat dhe mund të zgjatet apo shkurtohet një ose disa herë vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

## NENI 4 Objekti i veprimtarisë

Shoqeria ka per objekt veprimtarie:

Ne fushen e projektimit ne Ndertim, studime plane racionale urbanistike, plane rregullues te pergithshem per qendra te banuara, qytete, studime urbanistike, studime pjesore urbanistike, projekte objekte civile, industriale, turistike deri pese kate, projekte objekte civile, industriale, turistike mbi pese kate, projekte objekte sportive, projekte interiere, projektim pejsazhesh sistemime siperfaqe te gjelbera lulishte. furnizim me uje , kolektore shkarkimi , ujesjellesa kanalizime urbane , rurale , rruge auto kategoria V e IV , projektim shtresa rrugore e sistemim asfaltim , projektim urra e vepra arti deri 10 m , Ne zbatim ne Ndertim germime dheu ne punime eventuale , murature e beton arme , prishje dhe ne toke te germuar , Ndertime civile industriale , turistike , bujqesore deri 5 kate ndertime civile industriale turistike bujqesore mbi pese kate rikonstruksione .Ndertim banese me skelet mbi tete kate , Ndertim rruge kategoria IV e V , ndertim rruge kategoria III , II , I , punime te mirembajtjes dhe sinjalistikes , ne rruge , ndertim mbishtresa rrugore , ndertim autostrada , pista aeroporte , helioporte . ndertim tunele rrugore – hekurudhore dhe kompletimi me instalimet e nevojeshme per to. Ndertim ura e vepra arti deri 10 ml , ndertim ura dhe vepra arti mbi 10 m , estakada , ura metalike , te varura .Ndertim ujesjellesa , kanalizime , kanale e impiante vaditese .Ne fushen e prodhimit te materialeve te ndertimit Prodhim materiale inerte lumore e malore ( Konglomerate ) – gure gelqerore nga guroret malore , prodhime elemente betoni e beton arme te zakoneshme , te paranderur , gure dekorative , prodhim materiale lidhes , gelqere , cemento allci , betone , prodhime me baze bitumi e sintentike . Ne fushen e tregetimit me shumice e pakice , te import eksport prekin apo jo kufirin shqiptar te materialeve : ushqimore , industriale , lende te para , makineri e pajisje , automjete te transportit urban e te mallrave , makineri teknologjike ndertimi gjysem te gateshme , produkte , artikuj te konsumit farmaceutik , elektroshetepiake , konfeksione , bime medicinale , kozmetike , prodhim e tregetim te materialeve te ndertimit , pjese kembimi per makineri te ndryshme , makineri e automjete , , pika servisi , tregetim karburantesh , dhe vajra lubrifikante , hapje dyqane , bar bufe , restoran , hoteleri , si dhe ne fushen e automjeteve , si dhe ne perdonimin e lendeve plasese e shperthyese per nevoja civile, shperthim ne gurore per prodhim materialesh inerte , per perdonime ne germime te natyrave te ndryshme.

## NENI 5 Kapitali Themeltar

Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri.

Kapitali themeltar i shoqërisë me përgjegjesi te kufizuar eshte në vlerën 100,000 Leke dhe përfaqësohet nga kontributi i anëtarit te vetem themelue, i ndare ne një kuote. Ortaku i vetem themelues i Shoqërisë zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- **Znj. Vjollca Hoxha** ne cilesine e ortakut themelues zoteron 100 % te kapitalit social me vlore 100,000 Lek.

## **NENI 6** **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asamblea e Përgjithshme. Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve. Asambleja e Përgjithshme, vendos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë me shumice te parashikuar per ndryshimet ne Statut.

## **NENI 7** **Financimet e Ortakëve**

Ortakët, në bazë të një vendimi nga ortakët, mund të kryejnë financime në favor të shoqërisë me kundërshpërblim ose jo, me ose pa detyrimin e rimbursimit.

## **NENI 8** **Marredheniet ndermjet ortakëve**

Ortakët, e shoqërisë tregtare, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet perkundrejt shoqërisë apo ortakeve, per angazhimet e marra ne shkelje te interesave te shoqerise dhe ne dem te shoqerise , dhe vetem brenda investimit te tyre nese:

- a) abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare, ne kundershtim me ligjin apo statutin e saj, për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- b) trajtojne pronesite e shoqerise tregtare ne kundershtim me vendimet e asamblese se përgjithsme ose dispozitat e peraktuara nga administratoret qe rregullojnë perdorimin dhe shfrytezimin e tyre;

## **NENI 9** **Ndalimi i konkurrencës**

Ortakët nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimitari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë. Gjithashtu, ata nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimitari në këtë sektor.

Statuti mund të parashikojë që ndalimi i përmendur më sipër të shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga ortakët, apo nga asambleja e përgjithshme me 50%+1 te votave te favorshme.

Ky autorizim mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të përmendur në të, por jo për një periudhë më të gjatë se një vit pas humbjes së kësaj cilësie.

Nëse ndonjëri prej ortakëve shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:

- a) ta përjashtoje atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
- b) të kërkojë ndërprerjen e veprimitarisë konkurruese;
- c) të ngrejë padi për shpërbimin e dëmit.

Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërbimin e dëmit, mund t'i kërkojë secilit prej ortakëve:

- a) të pranojë se transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
- b) t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;

c) t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.

### **NENI 10** **Pronësia mbi kuotat**

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shit-blerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- në çdo mënyrë tjeter të parashikuar në ligj.

### **NENI 11** **Transferimi i kuotave nëpërmjet të gjallëve**

Ortakët e shoqërisë në rastet e transferimit të kuotave rezervojnë të drejtën e parablerjes së kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Në një rast të tillë kur ortaku kërkon të shesë kuota ose pjesë të saj, duhet të njoftojë pranë organit administrativ dhe tek ortakët e tjerë, nëpërmjet një letër rekomande duke specifikuar çminin dhe modalitetet e pagesës.

Brënda 30 (tridhjete) ditëve nga ky komunikim, ortakët e tjerë duhet të lajmërojnë nëpërmjet një letër rekomande nëse duan ta ushtrojnë të drejtën e parablerjes.

Kur afati 30(tridhjete) ditor kalon pa asnjë lajmërim nga ortakët, atëherë e drejta e parablerjes do të konsiderohet e ezauruar. Në një rast të tillë transferimi tek të tretët do të kryhet nëpërmjet pëlgimit të Asamblesë së Përgjithshme, e cila duhet të shprehet brënda 30 (tridhjete) ditëve nga marrja e kërkesës.

### **NENI 12** **Vdekja e Ortakut**

Transferimi i kuotave në rastin e vdekjes së një ortaku, si në mënyrë të veçantë dhe në mënyrë universale, do të kryhet sipas mënyrës së mëposhtme:

- shoqëria do të vazhdojë të kryejë aktivitetin e saj edhe vetëm me një apo të gjithë trashëgimtarët e të ndjerit.
- për përcaktimin e vlerës së kuotës së ortakut të vdekur e cila i takon trashëgimtarit të të ndjerit, në rast të likuidimit aplikohet nen 15 më poshtë.

### **NENI 13** **Largimi i ortakut nga shoqëria dhe likuidimi i kuotës**

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse :

- ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij,
- nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij,
- nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqerinë me shkrim, si dhe të parashitrojë shkaqet e largimit.

Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

Ortaku ka të drejtë të ngrëjë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpérblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrëjë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpérblimin e dëmit të pësuar.

#### **NENI 14** **Përjashtimi i ortakut**

Në bazë të një vendimi të asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortaku:

- mungese pagese e kontributit te nënshkuar nga ortaku;
- mungese pagese e kontributit si titull financimi, investimi , rritje kapitali i kerkuar per ortak;
- shkel detyrimet e përcaktuara ne statut;
- në rastin e sjelljeve me shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakeve, sipas dispozitave të Statutit;
- në prani të ndonjë arsyje tjetër të arsyeshme për të justifikuar përjashtimin e ortakeve;

Konsiderohen baza të arsyeshme për perjashtimin e një ortaku, me anë të shembullit dhe jo kufizim, rastet në të cilat ortaku:

- me qëllim apo me pakujdesi te rende shkakton dëme shoqërisë ose ortakeve te tjerë;
- shkelja me dashje apo me pakujdesi të akteve nënligjore statutore ose detyrimet sipas ligjit;
- perfshihet në aktivitete kundër interesave të shoqerise dhe që e bëjnë të pamundur vazhdimësinë e marrëdhënieve në mes shoqerise dhe ortakut;
- demton ose të pengon ushtrimin e aktivitetit të shoqerise tregtare;

Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkësë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.

Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpérblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin, sic parashikohet nga nenii 8. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpérblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

Ortaku nuk ka tē drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet pér shkaje tē arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi pér shpërbirim dëmi, ortaku ka tē drejtë tē kompensojë çdo shumë, që do tē kishte tē drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit tē kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

### **NENI 15** **Likuidimi i kuotës**

Në rastet e parashikuara më sipër në nenet 12, 13 dhe 14, kuotat do t'i likuidohen ortakut që largohet apo që përjashtohet, apo trashëgimtarëve të ortakut tē vdekur në përpjestim me pasurinë e shoqërisë.

Pasuria e shoqërisë do tē përcaktohet nga një raport i organit administrativ duke marrë njëkohësisht dhe mendimin e një eksperti kontabël në rast se shoqëria ka tē tillë, duke patur parasysh vlerën e tregut tē kuotave të zotëruara në ditën e vdekjes së ortakut apo në ditën e marjes së vendimit sipas ligjit pér largimin apo përjashtimin tē ortakut. Likuidimi i kuotave të zotëruara duhet tē realizohet brenda 180 (një qind e tetëdhjetë) ditëve nga dita në të cilën është vendosur likuidimi. Likuidimi mund tē bëhet nëpërmjet blerjes së kuotave nga ana e ortakëve që mbeten në proporcion me pjesën e zotëruar prej tyre ose me shitjen e kuotave tek një person i tretë, i cili është miratuar nga ortakët e tjerë. Në rast se kjo nuk arrihet, atëherë likuidimi do tē bëhet nëpërmjet përdorimit të rezervave ekzistuese të shoqërisë ose nëpërmjet zvogëlimit të kapitalit në proporcion me masën e kuotave që duhet tē likuidohet, me përjashtim tē rastit kur zvogëlimi vjen në kundërshtim me ligjin.

Në rast tē vdekjes së njërit prej ortakëve, trashëgimtari (ose trashëgimtarët) do tē ofrojë pér shitje kuoten ose kuotat e trasheguara ortakeve të tjerë tē shoqerise. Në rast se ortaket refuzojë pér tē blerë ose pér tē ushtruar tē drejtën e refuzimit sipas nenit te mëparshëm 11, trashëgimtari mund te mbaje pronesine e kuotave ose ti shese ato palëve tē treta.

### **NENI 16** **Administrimi dhe përfaqësimi**

Shoqëria mund tē administrohet në mënyrë tē alternuar, me vendim tē oratkëve sipas emërimit nga:

1. administratori i vetëm
2. nga dy apo më shumë administratorë me kopetanca tē përbashkëta ose tē veçanta, secili ne perputhje me kompetencat e shprehura nga asamblea e pergjithshme.

Ne vijim te themelimit tē shoqerise është miratuar forma administrative te nje (1) administratori. Kjo formë e administratës mund tē ndryshohet vetëm me rezolutë tē mëtejshëm tē Asamblese së Përgjithshme pér këtë qëllim.

Në rast se administratori emërohet pa ju referuar ndonjë rregulli pér ushtrimin e kompetencave tē administratorëve, do i bëhet referiment rregullave tē përgjithshme tē ligjit 9901, datë 14/04/2008.

Administratorët mund tē janë dhe jo ortakë.

Nuk mund tē emërohen administratorë dhe në rast se janë emëruar shkarkohen, ata që janë subjekti neneve 13 dhe 95 të ligjit 9901, datë 14/04/2008.

Afat i emërimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje nga ana e asmablese se per gjithshme.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administratorët do të përfitojnë një shpërblim të miratuar nga ortakët, do të kenë të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të kryera për arsyen pune, si dhe do të përfitojnë një shpërblim në rastin kur largohen nga detyra

Asamblea e Përgjithshme mund të emërojë përfaqësues të posaçem për punë të veçanta apo grup punësh dhe ti revokojë ata, mund të emërojë drejtorë, zv. drejtorë dhe agjentë, mund të ndërmarrë dhe përballet me çështje gjyqësore në çdo shkallë gjyqësore duke emëruar avokatë, përfaqësues dhe ekspertë dhe duke i revokuar ata.

Së fundi, administratorët mund të përfshijne në procedime ligjore dhe ti qëndrojë atyre përpara çdo juridiksi, në çdo fazë, duke patur autoritetin të emërojë avokatëve, prokurorëve dhe ekspertë, në varësi të mundësisë e tërheqjes apo te kete përfunduar ose të ndërpritet detyra.

Administratori i shoqerise "ANIMA 08" shpk do të jetë:

- **Znj. Vjollca Hoxha, shtetase Shqiptare, rezident ne Tirane, i datëlindjes 23/03/1969, mbajtes i kartes se identitetit nr. G95323231L.**

Administratori do te mund te rikonfirmohet me një vendim te posacem te asamblese në fund të mandatit pësë-vjeçar. Administratori përfaqëson shoqerine perpara organeve gjyqësore administrative ose ndonjë subjekte të tjera publike ose private dhe palëve të treta. Administratori i shoqerise do ti ushtrojne keto te drejta perfaqësimi si ligjore dhe proceduriale ne perputhje me parashtrimet ne statutin e shoqerise, dhe fuqive dhënë dhe sipas legjislacionit në fuqi dhe të zbatueshme në këtë çështje.

#### **NENI 17 Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve**

Administratori kryen aktivitetet ne vijim:

##### **1) Menaxhimi i Burimeve Njerëzore:**

- a) Krijimi dhe planifikimi i kërkessavete biznesit në lidhje me cilësinë dhe sasinë e burimeve njerëzore që do të përdoren në kompani;
- b) Te punësojë, te largoje nga puna, ne fushen e politikave të personelit, të punësuarit dhe bashkëpunëtorët, si dhe të vendosë për shpërblimin relativ te tyre ;
- c) Të përfaqësuar shoqërinë kundrejt edo institucionit social dhe sigurues, duke perm bushur kërkessat e dispozitave në fuqi në lidhje me punën.

## **2) Ligjore:**

- a) Të emërojë, shkarkojë, dhe të përcaktojë kompetencat e tyre;
- b) Të përfaqësuar shoqërinë ndaj çdo autoriteti apo administratë publike apo shteterore.

Administratorit, i atribuohet gjithashtu nënshkrimi i bilancit, raportin vjetor dhe shënimëve shpjeguese dhe deklaratat e nevojshme për t'i bashkëngjitet pasqyrave financiare sipas normativave ne fuqi.

## **3) Operativiteti:**

- a) të organizojë operativitetin dhe të ndjeke menaxhimin e aktiviteve kryesore të shoqerise;
- b) të lidhë kontrata për furnizim, në përgjithësi, duke përfshirë edhe ato të transportit, postar, qira, edhe financiare, të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në lidhje me aktivitetin e shoqerise. Per kontrata financimi e huaje kerkohet vendim asmableje nga ortaku i shoqerise.
- c) te kerkoje kredi dhe të bëjë pagesën e faturave të furnitorit në kufijtë e shpenzimeve të dhëna.

## **4) Administrative:**

- a) të organizojë dhe monitorojë aktivitetet e menaxhimit administrativ të kompanisë, të nenshkruaj kontrata të furnizimit me profesionistët dhe studio te administrimit të kontabilitetit, të bëjë ndonjë ankesë organit kompetent administrativ (Qendra Kombetare e Biznesit apo Zyrën e Tatimeve) sa i përket aktive me interes të shoqerise;
- b) të përfaqësuar shoqërinë me autoritetet tatimore dhe me fuqi administrative të nenshkruajë deklaratat tatimore.

Edhe pse nuk është e përfaqësuar në mënyrë specifike nga fuqitë e mësipërme, vendimet e administratoreve do të merren bashkërisht, duke përfshirë edhe hapjen e mardhenieve e llogarive bankar dhe marrëdhëniet financiare me ose pa mirebesim, dhe ndryshim te selise se shoqerise, hapje ose mbyllja e adresave sekondnare të shoqerise në territorin kombëtar të Republikës së Shqipërisë, në territorin e vendeve jashtë Bashkimit Evropian, ose në ndonjë vend tjeter të huaj ku eshte e nevojshme.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Administratori shoqerise nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakeve në asamble. Nëse asamblea e per gjithshe emeron, në vend të pluralitetit të administratoreve, një administrator te vetem, i nejti do kete fuqinë për të përfaqësuar shoqërinë, si dhe kompetencat e menaxhimit të administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm.

Kjo, në çdo rast, brenda kompetencave të dhëna nga asamblea e per gjithshme, dhe për kompetencat e përgjegjësisë ekskluzive të njëjta.

**NENI 18**  
**Asamblea e Përgjithshme**

Organi themelor i shoqërisë është Asamblea e Përgjithshme.

Asamblea e Përgjithshme , ndertuar mbi bazë të nenit 20, me shumicën e thjeshtë të votave të ortakeve qe marin pjesë në asamble vendos, ndër të tjera, dhe mbi ceshjet e mëposhtme:

1. aprovime dhe ndryhsime ne irregulla e procedura te lidhura me mbledhjen e asamblese se përgjithshme ;
2. percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
3. emerim dhe shkakrim te administratoreve;
4. emerim dhe shkarkim, nese eshte e nevojshme, e likujdatorit, eksperteve klontabel dhe audituesve te autorizuar;
5. percaktimin e shperblimeve per administratoret, likujdajtoret, ekspertet kontabel dhe audituesit autorizuar;
6. vezhgim mbi aplikimin, nga ana e administratoreve , te politikave tregtare, duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të biznesit;
7. perpjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
8. perfaqesimin e shoqerise ne Gjykata ne rast procedimesh perkundrejt drejtorëve;
9. raste të tjera të parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asamblea e Përgjithshme , kur konstituohet në mënyrë të vlefshme, merr vendime të cilat kërkojnë një shumicë të cilësuar prej  $\frac{3}{4}$  e votave të aksionarëve në rastet e mëposhtme:

1. ndryshimet ne statut;
2. shtim dhe zvogelim kapitali;
3. shperndarje e fitimeve;
4. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
5. raste të tjera të parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e Përgjithshme mblidhet , ne cdo rast, sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë duke përfshirë për shembull, rastet e mëposhtme

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- c) shoqëria, brenda dy viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara
- d) Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.

Në rastet e parashikuara në pikën a) dhe c) më sipër, përparrë asamblesë së përgjithshme paraqitet një raport i përgatitur nga një ekspert kontabel i autorizuar i pavavarur.

Në rastet e parashikuara në pikën a) dhe c) më sipër, administratoret mund të paraqesin ne Asamblene e Përgjithshme, duke ilustruar punën e shoqerise, çdo strategji dhe këshilla operative e financiare që do të kërkojnë miratimin e ortakeve.  
Ortaket janë të lirë për të proceduar me miratimin e këtij raporti ose të paraqesin vërejtjet dhe / ose shtesa të nevojshme.

#### **NENI 19** **Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.

Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7(shtate) ditë përparrat datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Asamblea e Përgjithshme, thirret në seline e shoqerise, ose në një vend tjetër, duke përfshirë çdo fushë të kombit-BE.

Eshte e mundur te mbahen takimet e Asamblese së Përgjithshme, edhe në qoftë se një ose më shumë anëtarë, pervec e Kryetarit dhe Sekretarit të emëruar si ne nenin ardhshëm 20, për të ndërhyrë në punën nga një vend tjetër, në shumë vende afér ose larg, përmes' përdorimi i mjeteve audio / video që sigurojnë identitetin e lehti te ortakeve pjesemarres.

#### **NENI 20** **Kuorumi i nevojshëm dhe vendim-marrja**

Asamblea e Pergjithsme , ne diten e themelimit dhe mbledhjes se saj , emeron si Kryetar me funksion drejtues te mbledhjes dhe si Sekretar akti , për hartimin e vete aktit. Një ortak mund të përfaqësohet nga ortaku, mbi bazën e një prokure apo autorizim te një anëtar tjetër ose një personi të tretë, jo domosdoshmërisht një ortak. Perfaqesimi apo prokura e leshuar me shkrim nga një nga ortaket e autorizon personin e deleguar për të marrë pjesë në një mbledhje të vetme të Ortakeve, me vlefshmërinë e asaj perfaquesuese ne Asamblene e Përgjithshme , është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 50%+1 te vleres se kuotave perfaquesuese te kapitalit.

Votimi mund të bëhet me prani të ortakut ose me ngjarjen kryer në një shkrim, me e-mail, solli në vëmendjen te Asamblese.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e përgjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve pjesëmarrës mbi ceshtjet e meposhtme :

- për ndryshimin e statutit,
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar,
- shpërndarjen e fitimeve,
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Për çështjet e tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i njedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.

## NENI 21 Proçesverbal i mbledhjes se asamblesë

Kryetari i emeruar nga Asamblea e Pergjithshme shpall vlefshmerine e themelimit te mbledhjes dhe kordinon zhvillimin e punes.

Sekretari duhet të regjistrojë të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duke hartuar procesverbalin.

Asamblea e Pergjithshme do të konsiderohet që kryhet në një nga vendet e referuara në nenin 19 dhe, në çdo rast, vendi ku janë njëkohësisht prezent Kryetari dhe Sekretari.

Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblee së Përgjithshme.

Procesverbal i duhet të përmbarjë rendin e ditës së mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetari dhe Sekretarit, si dhe rezultatet e shqyrtimeve dhe rezultatet e votimit.

Raporti është bashkangjitur edhe listën e personave të pranishëm në mbledhje.

Procesverbal i mbledhjes do të nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari.

## NENI 22 Hetimet e posaçmë

Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçmë për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjt ose të statutit në të kundërt brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkësës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.

E drejta për të kërkuar hetim të posaçmë, duhet të ushtrohet brenda 3 (tre) vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të

themelimit, si dhe brenda 3 (tre) vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

### **NENI 23** **Përdorimi i të ardhurave neto**

Të ardhurat neto, si rezultat i zbritjes së shpenzimeve të zbritshme të nevojshme për realizimin e aktivitetit në fjalë, do të konsiderohet në dispozicion të ortakeve të cilët do të vendosin të destinacionit, duke përfshire çdo ndarje të tij, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi dhe të zbatueshme në këtë çështje .

### **NENI 24** **Bilanci dhe plani financiar**

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë. Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

Bilanci vjetor i përgatitur në mënyrën e përshkruar më lart, ofron aktivet dhe pasivet e aktivitetit ekonomik të kompanisë, të shprehura në lekë ose valutë të konvertueshme. Dokumentet dhe të dhënat do të mbahen me standartet dhe në përputhje me gjuhën shqipe.

Kursi i këmbimit të monedhës shqiptare me monedhen e huaj dhe ne te kundert, përcaktohet në bazë të kursit të këmbimit zyrtar të përcaktuar nga Banka Qendrore e Shqiperise.

### **NENI 25** **Shpërndarja e fitimeve**

Ortaket kanë të drejtë për të shpërndarë lirisht në mesin e tyre një pjesë të fitimeve, që rezulton sipas bilancit më të fundit të miratuar nga Shoqeria. Fitimet do të shpërndahet ndërmjet ortakeve në përpjesëtim me kuotat e zoteruara ne shoqeri.

### **NENI 26** **Kufizimi i shpërndarjeve të fitimeve**

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendifit:

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratorët, pasi aprovojne pasqyrat financiare te shoqerise, lëshojnë një certifikatë të aftësishë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përbush kërkeshat e mësipërme.

Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësishë paguese.

Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigen personalisht përparrë shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

Ortaket të cilët kanë marrë pagesën e dividentit nga shoqeria, te kryera më pas në kundërshtim te administratorit dhe ne dem me parimet e përcaktuara në këtë nenë, do të kërkohet që të rikthejne për ne shoqeri shumën e marrë si dividentëve nëse:

- (i) nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese nga ana e administratoreve,
- (ii) pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë,

#### **NENI 27 Ekspertët Kontabël (Audituesit)**

Shoqëria cakton ekspert kontabël (Auditues) për çdo vit financiar kur jemi përparrë rasteve të përcaktuara në ligj.

Emërimin e tyre e bën Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.

Ekspertët kontabël (Auditues) mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullit të të gjithë dokumentacionit të Shoqërisë. Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë Shoqërisë nga mbajtja e parregullit e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesi, administratori, personat që janë gjini e krushqi me ata deri në shkallën e katërt.

#### **NENI 28 Marrdhëni e punës**

Marrdhëni e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Statutit dhe Legjisacionit Shqiptar të Punës.

Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontrates individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve.

#### **NENI 29**

Personeli administrativ dhe punonjësit janë përgjegjës për dëmin që i shkaktojnë kompanisë, përmashtrim apo neglizhencës së madhe, dhe janë përgjegjës para tyre në mënyrë të civilizuar brenda kohës ligjore dhe ligjeve në fuqi te zbatueshmë.

#### **NENI 30 Prishja e Shoqërisë. Likujdimi**

Kjo Shoqëri do të prishet dhe do te ndjekte proceduren e likujdimit pas ndodhjes se shkaqeve te meposhteme:

1. kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
2. me përfundimin e procedurave të falimentimit
3. apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
4. në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;

- në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga nen i 3/1 te ligjit per shoqerite tregtare;
- në raste të tjera, të parashikuara nga Asamblea e Pergjithshme;
- ka një rezolutë të veçantë te miratuar nga Asamblea e Pergjithshme;
- nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- merret një vendim gjykate;
- përvaja raste të tjera të parashikuara nga statuti ose me ligj.

Prishja e shoqërisë registrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit nga administratorët.

#### NENI 31 Likuidimi i shoqërisë

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Likuidimi vullnetar i kompanisë do të bëhet nga palët për këtë qëllim likuiduesit e emëruar nga Asamblea e Pergjithshme. Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda tridhjetë (30) ditësh pas materializimin e edhe një nga shkaqet e shpërbërjes, çdo person i interesuar mund të kërkojë nga zyrtari i gjykatës për të marrë emërimin e likuidatorit.

#### NENI 32 Dispozita të Fundit

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit.

#### NENI 33

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislationi tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### NENI 34

Ky Statut përpilohet në 4(kater) kopje në gjuhën shqipe dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortaku themelues në vendin e krijimit.

**ORTAKU THEMELUES**

Vjollca Hoxha

